



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKËA VLORË

PAZËSIA DHE PROJEKTET E TËRISJAZ, INTEGRIMIT EUROPIAN DHE DIASPORËS

№. 14852 Prot

Vlorë, më 24.09.2024

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

NË ZBATIMIN E SHQËRISË "VLORA PARKING" SH.A.
PËRÇKA PËR VLERËTIMIN DHE ADMINISTRIMIN E PËRQENDRIMIT NË RRUGË DHE
SHPËRNDARJE NË BASHKINË VLORË

Data: 28.09.2024 ora 17:00

Me referencë: Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 "Për votqeverisjen vendore" neni 18; Ligji nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", ligjit nr.146/2012 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregulloren e Organizimit dhe funksionimit të Bashkisë.

Partecipantët:

Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha, Drejtori i Drejtorisë Juridike-Dorian Demiri, punonjës të administratës së Bashkisë Vlorë, përfaqësues nga grupe interesi, media lokale.

Talibëria e hapit Kryetari i Bashkisë Vlorë, z.Ermal Dredha: Përshendetje, të gjithëve! Sot kemi mbledhur në vazhdimësi dhe në kuadër të reformave për shkak të angazhimit që kemi marrë në platformën që kemi shpалosur, që nga kandidimi por edhe gjatë zbatimit të detyrave, një nga problematikat që kemi hasur, është parkimi në segmentet kryesore. Dy janë pikat kryesore: e para, hapësirat publike që nuk janë shume dhe e dyta, rregullimi i trafikut. Duhen marrë masa konkrete. Ngritja e një sh.a publike që do të menaxhohet nga bashkia përveçse rregullon trafikun në qytet por edhe rregullon formatimin, vijëzimin grumbullimin e pagesës në bashki, në funksion të infrastrukturës së brendshme të qytetit. Kjo sh.a do të krijohet në mbledhjen e ardhshme të

këshillit bashkiak. Në shtator do krijohet bordi, në mbledhjet e tjera do marrë kohën në tatime, QKB, NIPT, dhe të bëhet funksional në janar. Tarifat nuk janë objekt diskutimi në këtë mbledhje të KB. Do ketë një dëgjese tjetër me qytetarët për tarifat dhe do sqarohet tamam. Detyrë tjetër e sh.a d të jetë identifikimi në terren i zonave publike për t'u kthyer në parkime publike. Disa zona që kemi diskutuar dhe studiuar në bulevardin kryesor i kemi ndarë në zona A dhe zona B.

Zona A i përket bulevardit dhe Luqomares.

Disa rrugë në Bulevardin Ismail Qemali:

Rruga Shaban Demiraj (tek rruga ura)

Rruga Ibrahim Avdullai (1 krah)

Rruga Duro Shaska (nbas Taushani 2 krah)

Rruga Murat Tërbazi (2 krah)

Rruga Meno Gjotekaj (1 krah)

Rruga Pavlo Billo (1 krah nga Regina)

Rruga Wilson (2 krah përjashtë rrëzimit të urës)

Fakulteti të Fushat e Sportit (1 krah dhe hapësira publike, krah të anëtar në shërbime nga bashkia)

Rruga Aleksandër Moisiu (1 krah)

Kjo është zona e bulevardit, kemi numëruar rreth 3000 vende parkimi. Janë përfshirë në proces por nuk do të paguajnë personat PAK me sinjalistikën përkatëse, është gati 3% e territorit. Si dhe parkimi i autobusave nuk do të përfshihet në pagesë.

Zona B

Shërbime tregtare dhe institucionale.

Rruga Hasan Kushta (2 krahë)

Rruga Pelivan Leskaj (2 krahë)

Rruga të pallatit Kollozi (2 krahë)

Rruga Demokracia (2 krahë)

Rruga Sulejman Delvina (1 krahë)

Rruga Kosova (2 krahë)

Rruga Gjergj Arani (2 krahë)

Rruga Hektor Shyti (2 krah)

Rruga Murat Tërbaçi (2 krah)

Rruga Gjergj Kastrioti (2 krah)

Zonat do të përcaktohen edhe në bazë të orareve me dy standarte.

Problemi është pikë i sezonit, do shikohet orari deri në 9 të darkës. Do të menaxhohet edhe për rezidentët, me kartë, do të jetë e gjitha në funksion të përmirësimit të shërbimit, do plotësojnë kritereve për shenjat identifikuese. E shtuna edhe e djela pushim, pa tarifim.

Sh.a. është iniciativë e Bashkisë për menaxhimin e parkimit të qytetit të Vlorës. Është e gjitha publike, jo private, për të mirën publike. Të ardhurat e gjeneruara do të shërbejnë bashkisë për të përmirësuar shërbimet. Janë të ekspozuara edhe në hartë për ndonjë paqartësi. Kush ka pyetje?

Qytetar: Përshëndetje. Kjo është një nismë që i duhet komunitetit. Pikat që kemi ne si biznese, të sikletshme, në shërbim të biznesit i cili ka nevojë për pjesën e furnizimeve, transportit edhe për kartën e rezidentit, si në çdo vend të botës. Për tarifën do të ishte mirë të mos ishim në nivelin e Tiranës sot. Mos të targetohet Vlora si qytet me çmime të larta. Në diskutimet tona kemi menduar që 500 lekë do të ishte mëse normale kjo do të shkoj paralele edhe me plazhet publike që do të ishte mirë të administrohen dhe ato nga bashkia. Të ndihmojnë turizmin. Pjesa e fondit që mbledhet në arkën e bashkisë. Përsa i përket fondëve që do mbledhen, të mbledhen sa më shumë në favor të bashkisë, pyetja ime është për transportin publik si do rregullohet sepse ka patur abuzime dhe nga taksitë për hapsirën dhe për çmimet e tritura në mënyrë abuzive.

Ernal Dredha: Ta filloj nga transporti. Jo më vonë se dje, patëm një takim me kompaninë e shërbimit dhe diskutuam për shtimin e mjeteve. Ka kosto financiare, shtim destinacioni sepse ka disa zona që kanë patur problem, psh zona e Zvernecit, s'ka shërbim transporti publik. Prandaj filluam dhe me investimin e parkimit te ajo zonë, në Manastir, ku përveç makinave ka vend për 4 autobusa. Këto kushte që po krijojmë kanë qëllim ta kthejnë në destinacion. Kemi patur disa kërkesa rishtasi për zonën e Sherishtës. Do shikojmë edhe pjesën nga deti. Orikumi psh ka problem me orarin dhe vendin, e kemi diskutuar, do shikohet në mbledhjen e KB. Do presim nga kompania dhe do shohim si do veprojmë.

Përsa i përket pjesës së plazheve, kemi ngritur grup pune dhe kemi bërë një studim edhe me drejtorinë e aseteve. Zona nga Pashalimani deri në Zvernec do shikohet në raport me plazhet publike, patjetër që hotelet kanë prioritet, nuk do jetë e gjitha publike, psh pjesa e pyjeve, aplikimet. Qeveria dhe Ministria e Turizimit i kanë dhënë prioritet komunitetit si dhe vizitorëve, kanë nisur nismën që hapsirat publike të menaxhohen nga bashkia dhe pastrimi dhe mirëmbajtja, të ofrohen shërbimet nga bashkia, të jenë në shërbim të komunitetit, dhe në këtë mënyrë të shmangim dhe konfliktet. Uroj të shkoj mirë.

Qytetar: Për taksitë.

Ernal Dredha: Është i njëjti proces. Të bien dakort. Zona e terminalit të autobusave, prioritet i joni, derisa të vijmë me projektin. Fond i dedikuar për të huazuar një studio projektimi për terminalin por edhe për projektet që i kemi prioritet. Edhe në bashkëpunim me drejtorinë e urbanistikës e cila po bën maksimumin. E kam thënë edhe në fushatërë, parkimet dhe të gjitha projektete që kërkojnë investim. Ti kemi në sirtar dhe të llobojmë për financim. Nuk është eksperimentale, është praktikë edhe e bashkive të tjera, hartimi i projekteve që ti kemi gati.

Qytetar: Bizneset ne lungomare, akses në parkim, kundrejt pagesës. Autobusi që zbret turistët në kohën e duhur, për turistët si do jetë tarifimi.

Ernal Dredha: Do e diskutojmë me Sh.a. parkimin me pagesë dhe kohën e shërbimit. Strukturat e lira, do shikojmë aksesin dhe hapsirën sipas rastit që mos të pengojmë trafikun.

Qytetar: Karta e rezidentit, a mund të përshpejtohet zonat që do pajisen me kartë. Te stadiumi, është zonë problematike, në mënyrë që mos të krijojë probleme kur të bëhet parkim me pagesë.

Ernal Dredha: kjo është e pamundur që të bëhet më përpara. Hapsirat mes pallateve do shikohen hap pas hapi dhe kartat e rezidentëve. Te stadium është parashikuar të jetë me pagesë. Është një proces i gjatë që do eci paralele, e rëndësishmë është që e kemi prioritet.

Qytetar: Të llogaritur nga deri te fahit.

Ernal Dredha: Do e diskutojmë edhe këtë. Bases është dhe pedonalja aty.

Qytetar: nga nga Oslo deri në Centrale. Cfarë zgjedhje do ketë për atë zonë?

Ernal Dredha: Do e rishikojmë. Nëse kanë ndonjë kërkesë administratorët meqë e njohin zonën dhe terrenin më mirë?

Ju falenderoj për kohën dhe pjesëmarrjen!

Koordinatorë për njoftimin dhe konsultimin publik

Albana Naçi

